



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Uprava za Opštu Administraciju
Directory of General Administration

Raporti i punës për periudhën Janar - Shtator 2023

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës së zyrtarit për Barazi Gjinore

- Pjesëmarrës në mbledhjen e parë si anëtar i KKS-së;
- Pjesëmarrës në ligjeratën Java e vetëdijësimit për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës, në shoqatën e gruas "Hareja" organizuar në bashkëpunim me QKMF Rahovec;
- Pjesëmarrës në konferencë me ftesë nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ku është bërë publikimi i të gjeturave të "Raportit për Vlerësimin Bazë të Dhunës në Baza Gjinore në Kosovë: Perceptimet e Komunitetit dhe Palëve të Interesit";
- Pjesëmarrës në mbledhjen e parë si anëtar i grupit të Komitetit Komunal Veprues;
- Marrja pjesë në takimin me ftesë nga Agjencia për Barazi Gjinore/ZKM, ku u prezantua Plani i punës së ABGJ për vitin 2023, si dhe shpërndarja e mirenjohjeve për zyrtaret e pensionuara të ABGJ.
- Takim me zyrtarët e USAID, arsyeja e takimit lidhur me një iniciativë e cila ka të bëjë me vlerësimin e kapaciteteve të Komunave partnere për të identifikuar dhe menaxhuar pronën e paluajtëshme komunale dhe procedurat për dhënien e pronës komunale dhe për të përgaditur specifikacionet teknike për hartën digjitale të komunave;
- Takim pune në zyrë me zyrtarin e OSBE-së Isliam Salihu, qëllimi i takimit ishte për organizimin e ndonjë aktiviteti për festën e gruas 8 Marsi;
- Takim pune në zyrë me kryetarin e komunës, qëllimi i takimit ishte për prezantimin e një "Plani ideor" për festën e 8 Marsit, ku kryetari kërkoj nga unë ti dërgohet me email "Plani ideor" për aktivitetet të cilat kërkohen;
- Pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore/ZKM në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike me temë "Parandalimi dhe trajtimi i rasteve të ngacmimit seksual në vendin e punës";
- Seanca e dytë e Kuvendit komunal, ku para fillimit të seancës kërkova nga Kryesuesi i kuvendit që të i njoftoj asambleistat dhe drejtorat e drejtorive gjatë seancës se deklarimi i pasurisë bëhet gjatë muajit Mars dhe se këtë vit bëhet në mënyrë elektronike;

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme

- Pjesëmarrës në punëtorin e organizuar nga (OSBE) në Kosovë, për anëtarët të emëruar rishtas të Komiteteve Komunale Vepruese lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre si dhe promovimin dhe funksionimin më efektiv të këtij mekanizmi lokal për zbatimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komunitetit dhe Planit të Veprimit për zbatimin e kësaj Strategjie për vitet 2022-2026 si dhe Planit të Veprimit për vitet 2022-2024, pjesëmarrës ishin nga tre komunat: K. Rahovec, K. Prizren dhe K. Suharekë.
- Takim pune me nënkryetarin dhe me kryetaren e grupit Joformal të grave për përgaditjen e ftesave me rastin e ditës ndërkombëtare të gruas 8 Marsi, organizuar nga Zyra për Barazi Gjinore.
- Pjesëmarrës në Marshin paqësor për ditën e guas 8 Marsi, organizuar nga shoqata e gruas "Hareja".
- Aktivitet për nder të 8 Marsit ditës ndërkombëtare të gruas.
Zyra për Barazi Gjinore në bashkëpunim me zyren e Kryetarit organizoi tryezë me gratë e ftuara: këshilltaret komunale, nënat dhe gratë e dëshmorëve, drejtoreshat e drejtorive, zyrtaret policore, drejtoreshat e shkollave, punonjëset komunale dhe OJQ-të. Ne duhet të ngrisim zërin për të drejtat e grave, për të drejtën në shkollim, në punë, të drejtën e fjalës dhe të lëvizjes së lirë. Gruaja është forcë dhe shtyllë e familjes. Aktivitet i përkrahur nga Komuna e Rahovecit.
- Takim me kryetarin e komunës dhe me grupin e performancës komunale, qëllimi i takimit ishte përgaditja e raportimit për performancë komunale;
- Marrja pjesë në mbledhjen e dytë si anëtar i KKSB-së;
- Takim pune në zyre me Zyrtaret nga USAID dhe drejtoreshën për Mbrojtje dhe Shpëtim, qëllimi i takimit ishte "Të drejtat e grave në regjistrimin e pronave, si dhe dhënia e disa statistikave që ato kërkuar për komunën e Rahovecit.
- Pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga Agjencia për Prandalimin e Korrupsionit, me të gjithë zyrtarët kontaktues, të nivelit qendror dhe lokal, në lidhje me këto dy tema:
- Njoftim me: "LIGJIN NR. 08/L-108, për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, si dhe njoftim me sistemin e deklarimit online të pasurisë.
- Dalje në teren si kryesues i komisionit për këmbimin e pronës, së bashku me dy antarët e komisionit, shikimi i vendit për këmbim që është në posedim të Org. Punuese Sharri (Pylltaria) për vlerësim.
- Pjesëmarrës në punëtorin dy ditore për zhvillimin e planit për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për Zyrën Kadastrale Komunale Rahovec, aktivitet i organizuar nga USAID - Qeverisja në pronë.
- Takim me antarët e Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave dhe të propozimeve për PZHK-në 2023-2031, si anëtar i komisionit.
- Pjesëmarrës në mbledhjen e anëtarëve të Këshillit për Siguri në Bashkësi (KKSB), ku është mbajtur takimi me kryetarët e fshatrave dhe lagjeve të qytetit.
Gjatë këtij takimi, u diskutua rreth vlerësimit të gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit.

KOMUNA RAHOVEC

- Pjesëmarrës në shoqatën e gruas “Hareja”, në kuadër të projektit “Ju nuk jeni vetëm” dedikuar personave të moshuar, ku i njoftuam gratë e moshuara për punën e bërë si Zyrtar për Barazi Gjinore, si dhe nga Policia e Kosovës.
- Pjesëmarrës në Sesionin informues nga Organizata Syri i Vizionit në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi në Komunën e Rahovecit në kuadër të projektit “Gratë dhe personat me aftësi të kufizuara si ndërmarrëse bujqësore në Kosovë” nga zonat rurale të komunës së Rahovecit.
- Pjesëmarrës në Punëtorin e Validimit për Protokollin e Çështjeve Gjinore dhe Përfshirjes Sociale, organizuar nga USAID Qeverisja e Pronës.
- Pjesëmarrës në puntorin me anëtarë nga Ekipi për të Drejtat e Fëmijës në Komunë, me temë Hartimi i Planit të Veprimit të EDF.
- Marrja pjesë në punëtorin dy ditore organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Agjencinë për Barazinë Gjinore Suedeze me Zyrtarët/et për Barazi Gjinore në nivelin lokal.
- Marrja pjesë në punëtorin e përbashkët nga MAPL në bashkëpunim me (OSBE-në), me qëllim të prezantimit të raportit të përmbushjes së obligimeve nga Agjenda Evropiane Janar-Dhjetor 2022, si dhe rishikimit të planit gjithëpërfshirës të komunave me obligimet e Agjendës Evropiane për vitin 2023.
- Përgaditja e buxhetimit gjinorë, për KABI-n 2024-2026 – Analiza Gjinore;
- Pjesëmarrës në takimin publik të kryetarit të komunës, me grupin e grave, rininë, bizneset dhe OJQ-të;
- Pjesëmarrës në takim me të rinjët në SHL-Kosova, debat me temën “Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore”, ku prezantova para të rinjëve detyrat dhe punën e zyrtarit për barazi gjinore;
- Trajnim për Sistemin e Menaxhimit të Performancës Komunale, organizuar nga MAPL në mbështetje të projektit DEMOS;
- Plotësim i pyetësorit nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Solidar Suisse, rreth përvojës dhe nevojave të zyrtarëve të institucioneve publike në lidhje me trajtimin e dhunës me bazë gjinore;
- Pjesëmarrës në konsultimin publik me gra për Qarkoren e parë buxhetore dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore në OJQ – Hareja;
- Përgaditja dhe dergimi i Planit gjithëpërfshirës për Agjendën Evropiane, Janar –Qershor 2023;

KOMUNA RAHOVEC

- Plotësim i pyetësorit nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Solidar Suisse, rreth përvojës dhe nevojave të zyrtarëve të institucioneve publike në lidhje me trajtimin e dhunës me bazë gjinore;
- Pjesëmarrës në konsultimin publik me gra për Qarkoren e parë buxhetore dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore në OIQ – Hareja;
- Përgaditja dhe dergimi i Planit gjithëpërfshirës për Agjenden Evropiane, Janar –Qershor 2023;
- Pjesëmarrës në Tryezë diskutimi me temën “Fuqizimi i bashkëpunimit ndër-institucional në promovimin e të drejtave të njeriut dhe qeverisjes së mirë”. Organizuar nga Avokati i Popullit;
- Takim në zyre me zyrtarët e USAID dhe drejtorin për gjeodezi dhe kadastër, me temën Shërbimet kadastrale komunale;
- Pjesëmarrës në dëgjimin publik në Sh.p.g. “Hareja” – Buxhetimi gjinor;
- Takim me kryetarin e komunës dhe grupin e performancës komunale;
- Pjesëmarrës në hapjes e festivalit të rrushit “Hardh fest” 2023;
- Pjesëmarrës në sesionin informues dhe punues mbi Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor, organizuar nga CARE International Ballkans me temat: Integrimi i perspektives gjinore në hartimin e politikave; Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor dhe benefitet; Analiza gjinore dhe iniciativat avokuese;
- Pjesëmarrës në mbledhjen e pestë të KKS-së.
- Marrja pjesë në punëtorin e përbashkët nga MAPL në bashkëpunim me (OSBE-në), me qëllim të prezantimit të raportit të përmbushjes së obligimeve nga Agjenda Evropiane Janar-Dhjetor 2022, si dhe rishikimit të planit gjithëpërfshirës të komunave me obligimet e Agjendës Evropiane për vitin 2023.

Punët shtesë me vendim të kryetarit të komunës:

- Zyrtar kontaktues për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhënave në Komunën e Rahovecit.
Regjistrimi në sistemin elektronik i personave zyrtarë që kanë për të deklaruar pasurinë si deklarim i rregullt gjatë muajit Mars.
- Zyrtar për Integritet Evropian - Kontrollimi për komente shtesë i Draft - Raporti i Përmbushjes së Obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane Janar - Dhjetor 2022;
- Raportimi për përmbushjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane, për periudhën Janar – Qershor 2023;
- Kryesues i disa komisionëve për vlerësimin e pronës komunale për këmbim, përgaditja e raportit për këmbimin e pronave komunale.

Alban Gashi

Zyrtar për Barazi Gjinore
Komuna Rahovec



18.09.2023

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme